



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2022:050533

Datë: 06.02.2023

Numri i dokumentit: 03943575

PPP.nr.277/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, rruga “...” ..., p.nr., përfaqësuar sipas autorizimit nga Kompania e Avokatëve “A.”, nga Hajvalia, KK. Prishtinë, rruga “...”, kundër debitorit I. K., nga Prishtina, rruga “...”, për pagesën e borxhit në vlerë prej 319.00 €, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të parashtruar kundër urdhrin mbi caktimin e përmbartimit P.nr.635/16, i datës 11.05.2016, të përmbartuesit privat F. B. si organ përmbartues, jashtë seancës me datë 26.01.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit I. K. nga Prishtina dhe SHFUQIZOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.635/16, i datës 11.05.2016, në shumën prej 319.00 €, i lëshuar nga përmbartuesi privat F. B., si organ përmbartues.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat F. B., si organ përmbartues, me urdhrin P.nr.635/16, i datës 11.05.2016, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit, ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr.720/13, të datës 12.06.2013, të lëshuar nga kreditori Kompania e Sigurimeve “S.”, e cila sipas nenit 21 të

Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje referuar si: LPP) paraqet bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ndërsa në bazë të nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të këtij ligjit paraqet dokument të besueshëm.

Kundër urdhrit për përmbartim P.nr.635/16, i datës 11.05.2016, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se përmbartuesi privat e ka lëshuar urdhrin pa bërë fillimisht vlerësimin dhe konstatimin e fakteve lidhur me obligimin e debitorit ndaj kreditorit. Më tutje ka theksuar se deri sa debitori ka punuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), sigurimin shëndetësor për punëtorët e KEK-ut në K.S “S.”, e ka paguar KEK-u dhe këtë pagesë e ka bërë duke ua ndalur një pjesë të të ardhurave punëtorëve, ndërsa që nga largimi i të njëjtit nga puna, thekson se nuk ka pasur njohuri se çfarë ka ndodhur, dhe gjithashtu nuk ka qenë asnjëherë në njohuri të faturës në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore. Më tutje ka vazhduar se edhe po ta kishte obligim ta paguajë faturën e lartcekur, ky detyrim tani është parashkruar, bazuar në nenin 362 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se “Kërkesat e siguresit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për 3 vjet”. Në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohen të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me përmbartim nga ana e Përmbartuesit Privat, dhe të anulohet urdhri përmbartimor P.nr.635/16, i datës 11.05.2016.

Kreditori, përmes të autorizuarit të tij, brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, duke theksuar se kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur propozimin për përmbartim, prandaj nuk qëndrojnë pretendimet që kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës. Më tej ka theksuar se po të mos ishte në dijeni debitori se siguron sigurim shëndetësor, i njëjti nuk do të paraqiste tek kreditori kërkesa-fatura për rimbursimin e shpenzimeve të krijuara, për shërbime stomatologjike, shërbime optike, pajisje të dëgjimit në shumën prej 250€, për analiza, e shërbime të tjera. Në fund i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, dhe të aprovojë propozimin për përmbartim të kreditorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të pasqyruara në prapësimin e paraqitur, propozimit për përmbarim, si dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka ardhur në përfundimin se prapësimi i debitorit është i bazuar.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv në këtij aktvendimi duke u bazuar të nenin 21 të LPP-së, sipas së cilit përcaktohet se “Organi Përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit të besueshëm (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, sipas nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 i LPP-së, përcaktohet faturat paraqesin dokument të besueshëm . Kurse, neni 29 paragrafi 3 i LPP-së përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim, po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit financiar”. Kurse, me nenin 43, paragrafi 4 i LPP-së është përcaktuar se: “Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Gjykata, pasi analizoi në tërësi dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën nr.720/13, të datës 12.06.2013, vërejti se propozimi për përmbarim është lejuar në shumën prej 319.00 €. Në rastin konkret prapësimi i debitori duhet të aprovohet si i bazuar dhe gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Gjykata ka marr këtë vendim, pas konstatimit se dokumenti i besueshëm, përkatësisht fatura nr.720/13, e datës 12.06.2013, në vlerën prej 319.00 €, në bazë të së cilës në petitumin e propozimit për përmbarim është kërkuar nga kreditori që të caktohet përmbarimi, dhe të detyrohet debitori t’ia paguaj kreditorit shumën e cekur më lartë, nuk përbën bazë juridike për caktimin e për mbarimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 21 dhe 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 3.

Rrjedhimisht, gjykata vlerësoj se kreditori me asnjë provë nuk ka mundur ta provoj faktin që fatura nr.720/13, e datës 12.06.2013, në bazë të së cilës është caktuar përmbarimi, i është dorëzuar debitorit. Kjo për faktin se fatura nuk është e nënshkruar dhe pranuar nga ana e debitorit, dhe si pasojë e kësaj debitori si në hyrje, nuk mund ta ketë cilësinë e debitorit, nëse në faturë është shkruar emri dhe mbiemri, por nuk është nënshkruar nga personi - subjekti me emër dhe mbiemër (firma) si në faturë. Kjo pasi që i njëjti nuk ka afruar asnjë dëshmi - dokument për t'i bërë të besueshme pretendimet e tij dhe që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur si në pikën I të dispozitivit.

Mbi bazën e asaj që u tha më lart, dhe në bazë të nenin 73 paragrafi të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.277/2022, datë 26.01.2023

Gjyqtari

Përparim Zeka

### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.